



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE

---

Kom.Dh.shk.II.nr.1234/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË - Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen përbarimore të kreditorit KRU Prishtina sh.a, me seli në Prishtinë, kundër debitorit ....., në fshatin ....., Komuna e Obiliqit, për shkak të borxhit, në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.2605/20, të datës 18.10.2021, jashtë seancës me datë 24.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit, KRU Prishtina sh.a, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.2605/20, i datës 18.10.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.2605/20, të datës 18.10.2021, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit të përbarimit ....., në fshatin .... të Komunës së Obiliqit, dhe ka shfuqizuar urdhrin mbi caktimin e përbarimit P.nr.1158/20 të datës 17.09.2020, të nxjerrë nga organi përbarues-përbaruesi privat Valdrin Beka. Në pikën II të dispozitivit të aktvendimit, e ka refuzuar si të pa bazuar propozimin për përbarim të kreditorit të përbarimit, KRU “Prishtina” sh.a, me seli në Prishtinë, Rr. “Hazir Shala”, nr.4.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, KRU “Prishtina” sh.a, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar të priset, dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, ose i njëjti të ndryshohet.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori KRU Prishtina sh.a, me seli në Prishtinë, me dt. 16.09.2020, ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës nr....., të dt.25.04.2018, për shumën e detyrimit në vlerë prej 70.20€, si dhe shpenzimet e përmbartimit sipas tarifës përmbartuesve privat në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr.06/2014 për Shpërblimet dhe Kompensimin e Shpenzimeve të Përmbartuesit Privat, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga pranimit të këtij urdhri.

Përmbartuesi Privat Valdrin Beka, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin përmbartimor P.nr.1158/2020 të dt. 17.09.2020, e ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori me datë 29.09.2020, ka ushtruar prapësim duke propozuar që të anulohet urdhri për përmbartim P.nr.1158/20 i datës 17.09.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka, si dhe të abrogohen të gjitha veprimet përmbartimore të ndërmarra lidhur me propozimin për përmbartim të datës 16.09.2020.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori me datë 07.10.2020, duke propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pa bazuar dhe i pa argumentuar në prova dhe në ligj, si dhe ka propozuar që gjykata me rastin e dhënies së ankesës ti caktojë debitorit shumën e garancionit deri në vlerën e propozimit sipas nenit 77 par.5 dhe nenit 78 par. 1.2 të LPP-së.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar PPP.nr.2605/20, të datës 18.10.2021, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhrin për lejimin e përmbartimit P.nr.1158/2020 të dt. 17.09.2020, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivit të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës ka ardhur në përfundim se prapësimi duhet të aprovohet si i bazuar, dhe ka vendosur si në dispozitiv, pasi që ka gjetur se përmbartimi në këtë çështje është caktuar nga organi përmbartues –përmbartuesi privat, pa u plotësuar në tërësi kushtet ligjore sikurse kërkohet me dispozitat e LPP-së, ngase kreditori i përmbartimit me asnjë provë nuk ka mundur të provojë faktin që fatura nr..... e datë 25.04.2018, në bazë të së cilës është caktuar përmbartimi i është dorëzuar debitorit të përmbartimit, dhe se kjo faturë nuk është e nënshkruar nga debitori i përmbartimit në mënyrë që debitori i përmbartimit ta ketë këtë cilësi nga po kjo faturë. Pra, nuk mund të konsiderohet .... si

debitori i përmbarimit nëse në faturë janë të dhënat për të, nëse fatura nuk është pranuar dhe e nënshkruar nga ....., e ky fakt nuk mund të argumentohet nga ana e kreditorit të përmbarimit me asnjë provë tjetër përcjellëse. Po ashtu, gjykata nuk i'a ka falur besimin dëftesës së dorëzuar nga kreditori i përmbarimit si dëshmi se fatura nr..... të datës 25.04.2018, debitori të përmbarimit i është dërguar përmes postës, për faktin se e njëjta fare nuk sqarohet se çka konkretisht i është dërguar debitorit të përmbarimit në adresën e tij, dhe se nuk mund të vërtetohet fakti se debitori të përmbarimit i është dërguar fatura nr..... e datës 25.04.2018. Sepse me nenin 43 par.4 të LPP-së, është përcaktuar se *“Përmbaruesit privat nxjerrin urdhrin për përmbarueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbarueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*.

Duke qenë se në rastin konkret ekziston njëri nga shkaqet që parashihet në nenin 30,37 dhe nenin 71 të LPP –së, që ka të bëjë me përshtatshmërinë për përmbarim të faturave si dokumente të besueshme, gjykata e shkallës së parë gjeti se e njëjta faturë nuk i përmbanë të gjitha tiparet që të jetë e përmbarueshme në procedurën e përmbarimit, pra nuk i plotësonë të gjitha kushtet ligjore që i parasheh neni 37 i LPP –së. Vendimin mbi shpenzimet procedurale e mori konform neni 13 të LPP –së lidhur me nenin 450 të LPK –së.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura. Por, dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbarimit së detyrimit monetar, kurse në rastin konkret kemi të bëjmë me dokumentin-faturën e cila nuk paraqet dokument të besueshëm, pasi që e njëjta nuk është e pranuar dhe nënshkruar nga ana e debitorit, dhe si e tilla nuk paraqet bazë juridike për caktimin e përmbarimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-së.

Gjithashtu, pretendimet ankimore të kreditorit lidhur me atë se gjykata e shkallës së parë ka harruar faktin se debitori është kompani private, dhe të gjithë procedurën e pranimit të shkresave dhe ankesave e pranon përmes zyrës së pranimit të tyre, dhe se fatura i është dërguar debitorit në

mënyrë të rregullt me anë të postës, Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë këto pretendime ankimore, kjo për faktin se Gjykata Themelore në Prishtinë, me të drejtë ka vlerësuar se nga dëftesa për pranimin e dërgesës nuk mund të sqarohet se çka konkretisht i është dërguar debitorit të përmbarimit në adresën e tij, pasi që në dëftesë është cekur vetëm marrësi ....., dhe destinacioni fshati ....., mirëpo nuk është përcaktuare nëse është dorëzuar faturë apo diçka tjetër.

Kjo gjykatë vlerëson se kreditori mund të iniciojë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tij rreth dëmit të shkaktuar nga debitori, mirëpo fatura në fjalë, në këtë fazë, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si e tillë, është e pa përshtatshme për përmbarim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë.

Andaj, duke marr parasysh edhe pretendimet tjera ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Dhoma e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka pranuar prapësimin si të bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhrin për caktimin e përmbarimit të Përmbaruesit Privat, P.nr.1158/2020 të dt. 17.09.2020.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NE PRISHTINË  
Dhoma e shkallës së dytë  
Kom.Dh.shkII.nr.1234/22 me datë 24.08.2022

Gjyqtari  
Krenar Berisha